



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:095287
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05545090

Ac.nr.10466/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, kundër të paditurit E.R, Xh.R dhe Z.R, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit Xh.R, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.1657/20, të datës 19.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit Xh.R dhe PRISHET pika I dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.1657/20, të datës 19.10.2021 dhe çështja kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

II.Aktgjykimi ankimuar C.nr.1657/20, të datës 19.10.2021, në pikën II të dispozitivit, mbetet i pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1657/20, të datës 19.10.2021, ka vendosur më sa vijon:

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit dhe DETYROHEN të paditurit Xh.R dhe Z.R, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit, në mënyrë solidare t'ia rimbursojnë shumën prej 593.00€, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 25.04.2011, me kamatë ashtu sic paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të vecantë, duke llogaritur nga data 28.08.2012 e deri në ditën e pagesës përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II.REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri E.R, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'ia rimbursojë shumën prej 593.00€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke llogaritur

nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III.DETYROHEN të paditurit Xh.R dhe Z.R, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, në mënyrë solidare t'ia kompensojnë shumën e te hollave në lartësi prej 15.00 euro për pagesën e taksës gjyqësore, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri Xh.R, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit i gabuar i së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën dhe ta prish aktgjykimin ankimor dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurve, për shkak të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 25.04.2011, me arsye sikurse në padi.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka filluar procedurën dhe pas marrjes së përgjigjes në padi, vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka marrë aktgjykimin e ankimuar duke arsyetuar se prindërit janë përgjegjës për dëmin që e ka shkaktuar fëmija i tyre i mitur dhe të njëjtit në mënyrë solidare i ka obliguar që paditëses t'ia rimbursojn shumën prej 593.00€, pasi që në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike se me datën 25.04.2011 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në fshatin Krilevë, Komuna e Kamenicës dhe se shkaktuesi i këtij aksidenti rrugor E.R atëherë i moshës 11 vjetarë nuk ka pasur polisë të sigurimit për mjedin e tij motorik motocikletë, natyrisht për shkak të moshës së patent shofer dhe se paditësja konform nenit 18 pika 1 paragrafi 1 të Ligjit Për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia e Republikës së Kosovës,/ Ligji nr.04/L-018 i datës 14.07.2011/ palës së dëmtuar ia ka kompenzuar dëmin material dhe tani konform nenit 18 kërkon rimbursimin e këtij dëmi nga të paditurit-prindërit e shkaktuesit të dëmit. Në nenin 18 pika 1 paragrafi 4 të Ligjit të lartëcekur është përcaktuar se „ Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat. Faktet e lartë cekura konfirmohen nga Raporti Policor 2019-CBT-0430 të dt.25.04.2011. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësja konform detyrimeve të saja ligjore e ka kompenzuar palën e dëmtuar në lartësinë prej 593.00€, ngase këtë fakt e konfirmon vet Ujdia jashtëgjyqësore, urdhër transferi bankar i dt.05.07.2011 dhe Vendimi nr. 758/2011 I datës 23.05.2011 me të cilin është kompenzuar pala e dëmtuar NPT. „, E,, po ashtu nuk është kontestues as fakti se shkaktuesi i dëmit E.R, në kohën e aksidenti ka qenë i moshës 11 vjeçar, pasi që këtë fakt e konfirmon Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan me numër serik E 20579290 dhe se nuk ka prova se në kohën e aksidentit të ketë pasur aftësinë e të gjykuarit, kurse nga përmbajtja e Ekstraktit të Gjendjes Civile konstatohet se të paditurit Xh. dhe Z.R janë prindërit të tij dhe konform nenit 165 të LMD, kanë përgjegjësi për dëmin që ka shkaktuar fëmija i tyre. Nga kjo gjendje e tillë faktike

se shkaktuesi i dëmit nuk është provuar se në kohën e aksidenti të këtë qenë i aftë për të gjykuar, Gjykata ka vendosur që conform nenit 165 të LMD-së / 30 Mars 1978/ në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „ Prindërit përgjigjen për dëmin që i shkaktojnë tjetrit fëmija i mitur i tyre që ka mbushur moshën shtatë vjeç, përveç në qoftë se provojnë se dëmi është krijuar pa fajin e tyre., të paditurit Xh dhe Z.R si prindër të të paditurit E.R të përgjigjen solidarisht për dëmin që ka shkaktuar fëmiju i tyre, ngase të njëjtit nuk e kanë vërtetuar faktin se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre, ngase në një moshë të mitur ia kanë blerë fëmijut motocikletën, për drejtimin e të cilës kërkohet edhe patent shoferi dhe polisa e sigurimit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika i) e lidhur me nenin 110 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të sipër theksuara, për arsye se të paditurve Xh dhe Z.R nuk ju ka dhënë mundësin e shqyrtimit të çështjes në gjykatë, gjegjësisht nga shkresat e lëndës nuk ka provë se të paditurit Xh dhe Z.R janë ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 22/09/2021, ndërsa në anën tjetër nuk dihet se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim që të konstatojë në procesverbal se të paditurit janë ftuar në mënyrë të rregullt. Sipas nenit 110 të LPK-së ligjvënësi ka paraparë: *Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t'i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar.* Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë, pasi që në bazë të thënieve nga ankesa e ushtruar, kjo gjykatë ka konstatuar se në këtë pjesë aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur nga palët ankuese.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që palët të ftohen në mënyrë të rregullt për seancë përgatitore/kryesore, dhe pasi vlerësimit të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, të vendosë në mënyrë meritorë për themelësinë e kërkesëpadsisë duke nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.10466/21, me datë 25/03/2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

Numri i lëndës: 2020:095287
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05545090

Liridon Maloku